



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 492, datë 28.12.2017

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit:
- a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e:
 - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve;
 - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ;
 - Tarifës së shërbimit.
 - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - d. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.

- e. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.

II. T’i rekomandojë UKT-së që:

- a. Aksionarët e UKT për ta bërë tregun sa më eficient duhet të vlerësojnë mënyrat alternative të financimit të nevojave financiare të UKT nëpërmjet kredive të buta/të lehtësuara ose nëpërmjet obligacioneve të qeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 10 158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe qeverisë vendore”.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS